



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 27.11.2024

Nr: 199

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË KRUJË, ME**  
**KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË ARDHMËRIA**  
**SHQIPTARE”, Z. PARID SHKËLQIM MIRI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

**VËREJ:**

Me shkresën nr. 986 prot., datë 15.02.2024, këshilli i bashkisë Krujë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Anila Bashkim Veseli, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Ardhmëria Shqiptare.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Ardhmëria Shqiptare, për këshillin e bashkisë Krujë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 05, z. Parid Shkëlqim Miri.

Me shkresën nr. 2796, prot., datë 24.09.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Krujë, z. Parid Shkëlqim Miri., me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Ardhmëria Shqiptare ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër DR-PASH-23528\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Parid Shkëlqim Miri, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT” të Formularit të Vetëdeklarimit:
- pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj? subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar  
“Është dënuar nga Gjykata Tiranë, me periudhë prove, në vitin 2019 për drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”;
- pyetjes 4 “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e ndonje vepre penale? subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar  
“Është arrestuar në Tiranë, në vitin 2019 për drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”;
- pyetjes 5 “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi apo jo? subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar  
“Është dënuar nga Gjykata Tiranë, me periudhë prove, në vitin 2019 për drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr. 2903 prot., datë 08.10.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2904 prot., datë 08.10.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Parid Shkëlqim Miri.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 11095/1 prot., datë 15.10.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Parid Shkëlqim Miri, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 15999/1 prot., datë 15.10.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Parid Shkëlqim Miri, ku konstatohet se kandidati rezulton i rehabilituar në bazë të nenit 69 Kodit Penal.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Parid Shkëlqim Miri, në këshillin e Bashkisë Krujë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

### **V E N D O S:**

1. Plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Krujë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Ardhmëria Shqiptare, z. Parid Shkëlqim Miri.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**